

Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në kapitullin e ardhshëm do të merremi me ngjashmërinë midis figurave ose formave. Figurat e ngjashme kanë të njëjtën formë, por jo doemos të njëjtën madhësi. Figura të barabarta janë ato që kanë të njëjtën formë dhe të njëjtën madhësi. Figura të tilla do t'i studiojmë me anë modelesh dypërmasore dhe tripërmasore, duke mësuar edhe për shkallën dhe faktorët e shkallës midis figurave të ngjashme.




Figura kongruente




Figura të ngjashme

Do të hetojmë edhe marrëdhëniet midis faktorit të shkallës, sipërfaqes dhe perimetrit të figurave të ngjashme. Do të mësojmë si të përpjesëtojmë vizatimet dypërmasore dhe objektet tripërmasore. Për shembull, modelet e trenave janë versione të përpjesëtuara të trenave realë dhe një glob mësimor është version i përpjesëtuar i Tokës.

Në mbyllje të kapitullit do të përdorim ç'kemi mësuar, për të zgjidhur një problem interesant: a është e mundur që një gjiganti 12 herë më të madh se ne t'ia durojnë kockat peshën e trupit? Bëni një parashikim tani, pastaj krahasojeni me përgjigjen në fund të kapitullit.

Fjalor Ja disa terma të rinj që do të mësojmë gjatë këtij kapitulli:

i barabartë
kënde përgjegjëse
anë përgjegjëse
kundërshembull

raporte të njëvlershme
herës
faktor i shkallës
i ngjashëm

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Po të hidhni një sy rreth e rrotull, do të dalloni pa tjetër shembuj formash të ngjashme: vizatime të përpjesëtuara, fotokopje të zmadhuara ose të zvogëluara, harta dhe territore reale që tregohen në ato harta, kuti të madhësive të ndryshme të të njëjtit lloj malli ose objekte të tjera. Mund të zbaviteni me fëmijën, duke gjetur forma të ngjashme dhe pastaj duke i matur, për të vërtetuar nëse janë të tilla vërtet.

